



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 247/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit Ndërmarrja për Qarkullimin e Derivateve të Naftës “K...”, me seli në Prishtinë, me NRB, të cilën e përfaqëson Visar Vehapi avokat nga Prishtina, kundër debitorit Republika e Kosovës, Qeveria - Ministra e Forcës së Sigurisë së Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 20/2019 të datës 18.01.2019 të Përmbaruesit Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Republika e Kosovës, Qeveria - Ministra e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ANULOHET urdhri përmbarimor P.nr. 20/2019 i datës 18.01.2019 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesit Privat Fadil Hoxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ndërmarrja për Qarkullimin e Derivateve të Naftës “K...”, ka caktuar urdhrin P.nr 20/2019 me datën 18.01.2019, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr 420/2017 të datës 10.09.2018, i plotfuqishëm prej datës 07.12.2018 dhe i ekzekutueshëm nga data 28.12.2018, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që menjëherë të i paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 556,707.38 Euro, me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si në mjetet e deponuara në kursim në afat mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 20.03.2008 e deri në pagesën e borxhit, si dhe shumën prej 2,355.00 Euro, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe tarifën e efikasitetit, me kërkesë që të inkasohet

borxhi nga xhirollogaritë e debitorit në konton e veçante bankare për kreditorët tek përmbaruesi privat me kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm, ashtu që pastaj përmbaruesi ti transferoj këto mjete në xhirollogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Debitori përmes Avokaturës Shtetërore, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke e kontestuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se e paditura ka paraqitur revizion lidhur me këtë çështje juridike, duke theksuar ndër të tjera se lidhur me këtë çështje juridike është hedhur poshtë padia, dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar ndërsa edhe në rast se nuk ka çështje të gjykuar kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar e po ashtu palës së paditur i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje juridiko kontestimore, duke shtuar se kontrata është mjet juridik i cili krijon të drejta dhe obligime në mes të palëve kontraktuese e në këtë rast palët nuk kanë pasur kontratë të shkruar as marrëveshje andaj edhe nuk ekziston asnjë obligim i të paditurit ndaj paditësit. I ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor ka theksuar se disa prej pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim kanë mundur të paraqiten vetëm me ankesë kundër aktgjykimit por jo edhe me prapësim në një procedurë përmbarimore, duke konsideruar se është më se e qartë se mjete i jashtëzakonshëm juridik nuk e ndalon ekzekutimin dhe se kjo është njohuri elementare dhe se ka me qindra vendime të gjykatave në këtë drejtim. Ka shtuar se arsyet e paraqitura në prapësim nuk janë arsye me të cilat mund të paraqitet prapësimi dhe se propozimi për përmbarim është bërë në bazë të aktgjykimit të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm duke i propozuar gjykatës që këtë prapësim ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe urdhrin e atakuar me këtë prapësim ta vërtetoj.

Debitori me datën 02.05.2019 përmes parashtresës i ka dorëzuar gjykatës, si provë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.nr 11/2019 të datës 18.03.2019 sipas të cilit është aprovuar si i bazuar revizioni i të paditurës dhe janë ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. Nr. 243/18 datë 7.12.2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr 420/17 datë 10.09.2018 dhe është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit. Duke i propozuar gjykatës që të refuzohet urdhri dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, parashtresës së debitorit të datës 02.05.2019, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 par.1 nën par.1.2 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, ka gjetur se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për faktin se dokumenti përmbartues - Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr 420/2017 i datës 10.09.2018, në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbartim, është ndryshuar dhe i njëjti e ka humbur efektin juridik.

Gjykata deri tek ky përfundim ka ardhur për faktin se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.nr 11/2019 të datës 18.03.2019, është aprovuar si i bazuar revizioni i të paditurës dhe është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë Ae.nr 243/2018 datë 7.12.2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr 420/2017 datë 10.09.2018, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses që të obligohet e paditura që paditëses t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 556,707.38 Euro, në emër të fitimit të pabazë, e cila rrjedh nga borxhi, me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim, me afat mbi një vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 20.03.2008 e gjer në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit si dhe kërkesa për pagesën e shpenzimeve procedurale në shumën prej 2,355.00 €. Për shpenzime të procedurës është vendosur që secila palë bartë shpenzimet e veta, ndërsa revizioni i të autorizuarit të paditëses i paraqitur kundër aktgjykimit të Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë Ae.nr 243/2018 datë 7.12.2018 është hedhur si i palejuar.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, i cili përcakton se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, vlerëson se në rastin konkret dokumenti përmbartimor, përkatësisht vendimi në bazë të cilit është lejuar përmbartimi

është ndryshuar me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe është refuzuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit, me ç'rast Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr 420/2017 i datës 10.09.2018 - si titull ekzekutiv dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë Ae.nr 243/2018 datë 7.12.2018, kanë humbur efektin juridik dhe si rrjedhojë ekzistojnë shkaqet e lartcekura, mbi bazën e të cilave duhet të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit dhe procedura përmbarimore të përfundoher në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par 1 nën par 1.2 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.247/22, datë 30.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.